



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 27.02.2014  
Nr. 0201-144

**PËR:** Halim Halimi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

**LËNDA:** Përgjigje në kërkesë

I nderuari Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka pranuar kërkesën nga ju për interpretim, lidhur me rastin e Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë Rajonale "Pastrimi" sh.a, i cili njëkohësisht është i zgjedhur anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011, për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë vlerëson se:

- Bazuar në nenin 65.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, drejtorët e ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës, nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të Komunës.
- Në shtojcën 2 të Ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi sh.a, Prishtinë, është përcaktuar si ndërmarrje lokale.

Nga ajo që u tha më lartë, kemi ardhur në përfundim se, Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes në fjalë, në zbatim të nenit 65.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale nuk mund të jetë në të njëjtën kohë, anëtarë i Kuvendit të Komunës edhe Kryeshef Ekzekutiv i ndërmarrjes.

MAPL, është e gatshme të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.


Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

**Kopje:** Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës  
Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së;  
Arkivit të MAPL-së.



28 JAN 2014



KOMUNËS SË PRISHTINËS

PËR: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

NGA: Feim Salihu, anëtar i Kuvendit të Komunës

LËNDA: Kërkesë për sqarim

DATA: 27.1.2014

#### I NDERUAR

Në bazë të rezultateve të publikuara nga KOZ – ja, për zgjedhjet lokale të telorit të viti 2013, jam zgjedhur anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës prej subjektit LDK.

Kandidimi im për këtë post politik është bërë pasi që unë nga leximi i dispozitave të ligjeve në fuqi: Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjit për ndërmarrjet publike jam siguruar se mbajtja e postit të Kryeshefit ekzekutiv të Kompanisë rajonale të mbeturinave (kompani me aksione të disa komunave) nuk bie ndesh që njëkohsisht të jam edhe anëtar i Kuvendit të Komunës.

Duke pasur parasysh se jam i përcaktuar në respektimin e ligjeve, përmesë kësaj kërkesë nga Ju kërkojë të më jepet sqarimi se:

Mbatja e postit kryeshef ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi", SH.A. është/nuk është pengesë që të jam anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Jam i gatshëm që lidhur me kërkesën e ushtruar të jep edhe shënime tjera.

Me respekt

Feim Salihu